



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësi org. Org.Jedlinica Org.Unit	<u>KAMC</u>
Nr. i Faqeve Bc. Stranica No. Pages	<u>- 09 -</u>
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	<u>7060-2/23</u>
Data: Datum: Date:	<u>09.03.24</u>
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	15.02.2024
REFERENC-Ë:	7060/23 - ZSP- 2024
PËR/ZA/TO:	„MALËSIA GROUP“ Rr. 28 Nëntori, K. Podujevë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së Z. Naser AFIZI, Zëvendësues i drejtorit të ARPP-së Z. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Leje Ujore

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin tekniko-investiv, për shfrytëzim të ujit, me Nr. të protokollit: 7060/23, parashtruar nga „MALËSIA GROUP“ Sh.p.k. dhe ka vendosur si në Vendim për Leje Ujore, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

LU

Datë: 15.02.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ, MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës „Malësia Group” Sh.p.k. për shfrytëzimin e ujit nëntokësor nga Puset, me nr protokoli 7060/23, datë 01.02.2023, K. Podujevë për betonjerë, sipas kushteve vijuese:

1. Sasia maksimale për shfrytëzim e ujit nëntokësorë nga Pusi 1, me koordinata: (X=7 516 745.344; Y=4 752706.364) është $Q_{max}= 3.2$ l/s (tre pikë dy litra për sekond), dhe Pusi 2, me koordinata (7 516778.541; Y= 4 752 702.645) me $Q_{max} = 7.6$ l/s (Shtat pikë gjasht litra per sekond) në parcelen kadastrale, P-71712062-00797-2; sipas Dokumentacionit të dorëzuar Tekniko – Investiv;
2. Pala përmes regjistrimit me anën e ujëmatësit, duhet të evidentoj: Prurjen mesatare ditore (l/s), sasinë ditore (m^3 /ditë), dhe sasinë vjetore (m^3 /vit);
3. Për sasinë e shfrytëzuara pala obligohet, që për çdo gjashtë muaj, të informoj me shkrim ARPL/MMPHI, nga momenti i marrjes së lejes ujore;

Faqe 2 nga 4



4. Nr. Serik i ujëmatësëve për Pusin 1&2 , duhet prezantuar në ARPL/MMPHI, brënda 15 dite dhe të njejtët nuk mund te ndryshohet, për ndërrimin e mundshëm të tyre duhet informuar Organi përgjegjës që e ka lëshuar këtë vendim;
5. Obligimi për kompensimin e ujit të shfrytëzuar, do të përcaktohet me aktvendim të posaçëm nga MMPHI, sipas Udhëzimit Administrativ në fuqi, për Strukturën e Pagesave të Ujit;
6. Për këtë pala obligohet të raportoj shfrytëzimin, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbi sasinë e shfrytëzuar të ujit të matur përmes Ujëmatësit, ashtu që të plotësohet kushti paraprak;
7. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (Pesë) vite, me mundësi vazhdimi sipas kërkesës së palës;
8. Për vazhdimin e kohëzgjatjes së Lejes Ujore, bartësi është i obliguar që 2 (dy) muaj para skadimit të afatit, të paraqes kërkesë për vazhdimin të lejes ujore;
9. Në rast se pala vendos, lidhur me rritjen apo zvogëlimin e shfrytëzimit, duhet të bëjë kërkesë për ndryshim të lejes ujore;
10. Leja ujore nuk mund të bartet tek personat e tretë, pa informimin e organit kompetent që e ka lëshuar të njëjtën;
11. Validiteti i Lejes Ujore pushon, në rast të mos plotësimit të kushteve të kërkuara më sipër.

ARSYETIM

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim: “Dokumentacioni Tekniko - Investiv për Shfrytëzim të ujit –Studim elaborati i hulumtimeve hidrogjeologjike për betonjerë’ Kontratë mbi qiranë e patundshmërisë, LRP-nr. 4916/2022. Nr. Ref. 731/2022, ne mes te Qiradhënësit N.T.P. Malësia Commerce dhe Qirramarrësit “Malësia Group” sh.p.k.; Ceetifikate regjistrimit të biznesit , me nr (811404954); Pëlqim mjedisorë , me Nr 22/4412/ZSP /118/22. Datë 09.08.2022; Kopje Plani për parcelen P-7172062-00797-2; Certifikata e Pronësisë; Situacioni Gjeodezik Hartuar, nenshkruar dhe vulosur nga person fizik i licencuar i lëmisë përkatëse “Geo Cad” , me nr. licence 30; dokumentacioni i hartuar nga ”Geomjedisi“ me Ekipin me profesione të ndryshme përkatëse për ekspertizë, Preznatimi i konstrukcionit të Pusit 1 si dhe test pompimet, thellesi 20 m & konstrukcionit të Pusit 2, thellësia 42 m; Certifikata e regjistrimit të biznesit, të kompanise hartuese, Certifikata e nr fiskal; diploma e hartueses se projektit hidrogjeologjis, Diplomë e hartuesit te projektit te dorezuar, Z. Vehbi Gogjuli; Argjent Muharrem Collakaj , bacellor i nder . – drejtimi hidroteknikes, pagesat e tarifes me rastin e aplikimit për kushte ujore, pelqim uJOR dhe leje ujore; si dhe CD-në. Andaj bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, bazuar në shikimin në vend, datë 19.01.2024, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE :

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në iniciimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën Kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr: 7060/23 - ZSP- 2024, datë: 15.02.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Podujevë;
- Arkivit të Ministrisë.

Zavëndësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së

